

MËSIMI TETË

Kthim sërish te bazat

Përmes Fjalës së Tij, Perëndia u siguron besimtarëve të vërtetat thelbësore që na nevojiten për fillimin, vazhdimin dhe përmbushjen e shpëtimit tonë. Megjithatë, duke shpresuar që të zbulojmë ide të reja, ne shpesh i harrojmë bazat. Alistair Begg-u i paralajmëron pastorët që t'i kujtojnë vetes dhe atyre që janë nën kujdesin e tyre, se Vetë Perëndia është burimi i vetëm i së vërtetës. Populli i Perëndisë nuk duhet të lodhet kurrë së dëgjuari premtimet e çmuara që ka bërë Ai.

Shënime

Kujtesa ka rëndësi

Një besim i përbashkët

“Premtime të çmuara”

Shtojini besimit tuaj

Tregimi i një dëshmitari okular

Siguria e Fjalës

SHKRIME KYÇ

“Prandaj nuk do të lë pas dore t’ju kujtoj gjithnjë këto gjëra, ndonëse ju i dini dhe jeni të forcuar në këtë të vërtetë. Por unë mendoj se është e drejtë, përderisa jam në këtë tendë, t’ju mbaj zgjuar duke jua sjellë këto gjëra ndër mend.” (2 e Pjetrit 1:12–13)

“Ne e kemi edhe më të përforcuar fjalën profetike, së cilës bëni mirë t’i kushtoni kujdes, si një kandil që ndriçon në një vend të errët, derisa të zbardhë dita dhe ylli i mëngjesit të lindë në zemrat tuaja.” (2 e Pjetrit 1:19)

Vështrim në thellësi

1. *“Çfarëdo tjetër qoftë përgjegjësia jonë, ne jemi ... burra të veçuar nga Perëndia për kujdesin e shpirtrave. Kjo gjë duhet të na mbajë zgjuar natën, po ashtu, kjo duhet të na bëjë të zgjohemi në mëngjes dhe të hidhemi në veprim.”*

Pastorët janë thirrur të mbikëqyrin, të shërbejnë e të kujdesen për popullin e Perëndisë. Është shumë e lehtë që pastorët ta harrojnë thirrjen dhe t’i lënë pas detyrat e tyre. Pse duhet që ta shikoni këtë thirrje me seriozitetin më të madh?

2. *“Është shumë e rëndësishme që të sigurohemi se nuk po i lëmë në baltë ata që janë nën kujdesin tonë, duke harruar që t’u kujtojmë gjërat thelbësore.”*

Udhëheqësit e shërbesës do të tundohen që t’u bëjnë përshtypje dëgjuesve të tyre me idenë apo shpikjen më të re të krishterë, por shërbesa e krishterë duhet që të përqendrohet kryesisht te rikujtimi i të krishterëve për ato të vërteta të cilat tashmë i dinë. Në shërbesën tënde, si mund të sigurohesh që po u kthehesh të njëjtave të vërteta themelore të Ungjillit në mësimdhënien dhe predikimin tënd?

3. *“Kur e humbasim sigurinë në autoritetin, mjaftueshmërinë dhe sigurinë e këtij libri, atëherë do të sjellim në skenë valltarët, atëherë do të sjellim dritat, atëherë do të sjellim shfaqjet, pastaj do të sjellim atë tipin, burrin më të fortë në Amerikë, që i thyen me kokë shufrat e trasha të akullit.”*

Siç e vë në dukje edhe Alistair-i, siguria jonë te Bibla (apo mungesa e saj) do ta ndikojë praktikën tonë në shërbesë. Vlerësoji praktikën e shërbesës sate të tanishme. A zbulojnë ato sigurinë tënde në Fjalën e Perëndisë apo në diçka tjetër? Pse është e kotë që të përpiqesh ta rritësh kishën me ndonjë gjë tjetër përveç Fjalës së Perëndisë?

Mënyra për t'u lutur

- Kërkoji Zotit që të të ndihmojë të jesh i zellshëm në thirrjen e shërbesës sate.
- Lutu që të gjithë të krishterët në kishën tënde dhe në kishat e tjera të komunitetit tënd të kërkojnë unitet në besimin e tyre të përbashkët në Krishtin. Kërkoji Zotit që ta ruajë kishën nga mbështetja e unitetit në çështje dytësore apo madje mbi kundërshtimin e gjërave të rreme të botës.
- Kërkoji Zotit të të mbrojë nga hipokrizia. Lutu që Zoti të të ndihmojë t'i zbatosh në jetën tënde të vërtetat që predikon, para se t'u bësh thirrje të tjerëve të reagojnë ndaj Fjalës së Perëndisë.

EPILOG

Të jesh një pastor

Mësime kyç

Përgjigju pyetjeve të mëposhtme duke u bazuar mbi atë që ke mësuar nga predikimet e këtij vëllimi.

1. Cilat janë shenjat e një shërbese të dhënë nga Perëndia?

2. Cila duhet të jetë qasja e një pastori ndaj themelimit dhe mbjelljes së një vizioni në kishën lokale?

3. Pse është e rëndësishme që pastorët t'i pajisin shenjtorët për veprat e shërbesës?

Për lexim dhe studim të mëtejshëm

- *On Being a Pastor: Understanding Our Calling and Work* nga Derek Prime dhe Alistair Begg
- *David Martyn Lloyd-Jones, vëllimi 2, The Fight of Faith: 1939–1981* nga Iain H. Murray
- *Memoirs of the Life of the Rev. Charles Simeon*, redaktuar nga William Carus
- *Zeal without Burnout: Seven Keys to a Lifelong Ministry of Sustainable Sacrifice* nga Christopher Ash
- *Seven Leaders: Pastors and Teachers* nga Iain H. Murray
- *Devoted to God: Blueprints for Sanctification* nga Sinclair Ferguson
- *Lectures to My Students* nga Charles Spurgeon



ALISTAIR BEGG u diplomua në London School of Theology dhe ka qenë në shërbesë pastorale që nga viti 1975. Ai ka shërbyer si pastori kryesor i kishës “Parkside” në rrethinat e Cleveland-it, Ohio, që nga viti 1983 dhe është mësuesi i Biblës në programin e përditshëm *Truth For Life*. Ai është autor i disa librave, ku përfshihen *On Being a Pastor* dhe *Truth For Life: 365 Daily Devotions*. Ai dhe bashkëshortja e tij kanë tre fëmijë të rritur.

KY UDHËZUES STUDIMI U SIGURUA NGA

TRUTHFORLIFE®

THE BIBLE-TEACHING MINISTRY OF **ALISTAIR BEGG**

P.O. Box 398000 Cleveland, Ohio 44139

ph 1 (888) 588-7884 email letters@truthforlife.org truthforlife.org